



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina

---

### EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së tretë të Komitetit për Politikë dhe Financa të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 15.03.2012, e cila filloi në orën 15:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Sami Hamiti, Mustafë Krasniqi, Tefik Mehmeti, Hazir Borovci, Engin Beyoglu, Aziz Pacolli, Milazim Vitia, Shemsi Veseli dhe Shefqet Sylejmani.

Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive të Komunës dhe përfaqësuesit e OSBE - së.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Sami Hamiti, kryesues, i cili i informoi të pranishmit se në mbledhjen e radhës së Kuvendit, do të shqyrtohen vetëm tri raportet e para sipas rendit të ditës, ndërkaq dy të tjerat do të shqyrtohen në mbledhjen e ardhshme, së bashku me raportin e NPK “Sport - Marketng” dhe Informatën e Policisë.

Aziz Pacolli bëri vërejtje lidhur me plasimin e informatave të dhëna nga ana e medieve.

Shefqet Sylejmani tha se këto shqetësime janë edhe tonat dhe përkrahu mendimin e zotit Pacolli, dhe propozoi që të përfshihet në pikën “të ndryshme” të rendit të ditës.

Shemsi Veseli shtoi se këto janë politika redaktuese, andaj do të duhej që Zyra për informim t’i plasojë këto diskutime dhe ta sqarojë këtë çështje.

Kryesuesi ceku se kjo çështje ka arritur kulmin me gazetën “Kosova sot” dhe se Këshilli i Pavarur i Mediave ka vlerësuar se është bërë shkelje me Komunën e Prishtinës, dhe kjo do të shqyrtohet në pikën “të ndryshme” të rendit të ditës.

Njëzëri u miratua ky

### REND DITE :

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së dytë;
2. Informata e kryeshefit ekzekutiv të kompanisë së ujësjellësit rajonal “Prishtina” SH A, për investimet në përmirësimin e furnizimit me ujë në komunën e Prishtinës;

Faqe 1 nga 5

---

3. Propozimvendimi për shfuqizimin e Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për shfrytëzimin e përkohshëm të pronës komunale për vendosjen e objekteve të përkohshme;
4. Raportet vjetore të komisioneve të aksionarëve të ndërmarrjeve publike lokale:
  - a. NPK "Hortikultura",
  - b. NPK "Termokos",
  - c. NPK "Pastrimi",
  - d. NPK "Trafiku Urban" dhe
  - e. NPK "Ndërmarrja Publike Banesore";
5. Të ndryshme.

Para se të fillonin me rendin e ditës, **kryesuesi** i njoftoi të pranishmit se edhe këtë herë Komuna e Prishtinës ka fituar donacione për transparencë.

#### **Pika e parë**

**Njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së tretë.**

#### **Pika e dytë**

**Kryesuesi** tha se për këtë informatë do të njoftohemi në mbledhjen e Kuvendit.

**U konstatua njëzëri që Informata e kryeshefit ekzekutiv të kompanisë së ujësjellësit rajonal "Prishtina" SH A për investimet në përmirësimin e furnizimit me ujë në Komunën e Prishtinës, të shqyrtohet në mbledhjen e Kuvendit.**

#### **Pika e tretë**

**Behxhet Musliu** informoi lidhur me këtë pikë.

**Agim Salihu** paraqiti sqarime shtesë.

**Agim Gashi** paraqiti sqarime lidhur me veprimtarinë e shërbimeve publike.

**Aziz Pacolli** tha se pa një plan urbanistik ose pëlqim nga Drejtoria e Planifikimit, Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, të mos jepen as lejet e përkohshme.

**Shefqet Sylejmani** u shpreh se po e sheh një gjë të mirë në shprehjen e mendimeve të ndryshme nga ana e përfaqësuesit të drejtorisë dhe të Zyrës ligjore, por nuk është mirë që po vihet në mbledhje pa i harmonizuar mendimet, andaj propozoi që kjo të bëhet paraprakisht.

**Shemsi Veseli** propozoi që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen e radhës, duke shtuar se nuk ka nevojë të bëhen dualizma.

**Kryesuesi** tha se në mbledhje duhet paraqitur propozim të verifikuar, andaj kjo pikë e rendit të ditës shtyhet për mbledhjen e radhës.

## Pika e katërt

**Aziz Pacolli** kundërshtoi mënyrën e tillë të punës përkitazi me raportet e NPK-ve, në veçanti të asaj "Pastrimi", duke thënë se është thirrur vetëm për nënshkrimin e raportit, i cili tregon historikun e ndërmarrjes e jo punën e saj. Ai gjithashtu ceku se nuk ka pasur asgjë me shkrim, madje as për problemet e shumta të kësaj ndërmarrjeje, duke potencuar mospajtimet e saj me Komunën e Lipjanit.

**Kryesuesi** bëri vërejtje në punën e bërë rreth këtij raporti dhe kërkoi që nëse ai raport nuk pranohet, së paku të mos shantazhohet.

**Shefqet Sylejmani** u pajtua me konstatimin e kryesuesit, duke thënë se nuk është mirë që komisionet e aksionarëve të ndërmarrjeve publike, pas krejt asaj pune që kryejnë, të mos kompensohen. Pasi jemi pjesëmarrës të këtyre komisioneve, atëherë nuk është mirë të mos angazhohemi rreth raporteve dhe të shantazhojmë me mos nënshkrim. Në faqen e parë të raportit të Ndërmarrjes Publike Banesore, në pjesën e historikut, është bërë politizim rreth emërtimit. Ai gjithashtu tha se është raport i punuar mirë dhe pyeti përfaqësuesin e Zyrën ligjore se a duhet në këtë raport të thuhet diç edhe për problemet rreth mirëmbajtjes së objektit në kompleksin banesor "Dielli" në "Kodrën e Diellit" dhe a mund të inkorporohet ky kompleks në kuadër të kësaj ndërmarrjeje. Ka probleme që lidhen me uzurpimin e banesave, sidomos të atyre përballë Fakultetit të Filologjisë dhe të lagjja "Kodra e Diellit 2". Janë probleme që ndërlidhen me ndërmarrjen dhe shihet një angazhim serioz për realizimin e të drejtave të saj karshi uzurpatorëve. Tek të gjitha shpenzimet shihet se është vepruar me nikoqirllëk më të mirë të mundshëm. Njëra prej vështirësive mbetet pozita e mos stimulimit material për anëtarët e bordit.

**Shemsi Veseli** tha se këto raporte nuk janë të mirëfillta dhe u pajtua me mendimin që anëtarët e bordeve duhet të paguhen. Në këto raporte mungon pasqyra e pronave dhe nuk jepen sqarime lidhur me shumatat e prezantuara. Pyeti se a është informuar Këshilli i Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Banesore lidhur me vendimet e marra për shitjen e banesave, të gjeturat e auditorit etj. Flitet për transparencë, por ajo nuk ekziston. Nuk ka të dhëna për numrin e punëtorëve, nivelin e pagave të tyre etj. Të njëjtat vërejtje vlejné edhe për ndërmarrjet e tjera.

**Kryesuesi** u përgjigj në pyetjet e parashtruara dhe paraqiti sqarime shtesë.

**Shefqet Sylejmani** tha se pajtohet me vërejtjet e dhëna dhe shtoi se jemi të pakënaqur me statusin e rregulluar në këtë mënyrë. Neve nuk na jepet mundësia të bëjmë asgjë dhe nuk kemi hapësirë veprimi.

**Mustafë Krasniqi** shtoi se Komisioni i Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike "Termokos" i ka të gjitha shënimet, të cilat sipas nevojës do t'i paraqesë këtu dhe në mbledhjen e Kuvendit. Ai gjithashtu raportoi edhe për sfidat e shumta në të cilat ka hasur kjo ndërmarrje, duke shtuar se janë munduar të paraqesin pasqyrën reale të punës së saj.

**Tefik Mehmeti** shprehu mendimin se si është statusi i aksionarëve, ashtu është edhe gjendja e këtyre raporteve, njëherësh shprehu habi se si nuk gjendet ndonjë formë për pagesën e anëtarëve të këtyre komisioneve. Ne nga aksionarët kërkojmë raporte të shkurtra mbi specifikat e ndërmarrjeve në të cilat janë caktuar. Borxhet e NP - ve “Termokos” dhe “Pastrimi “ janë bartur që nga paslufta dhe ne tani duhet të merremi me to, andaj është dashtë që të gjitha këto raporte të jenë më të shkurtra dhe koncize.

**Aziz Pacolli** shtoi se fajtor për raporte të tilla është mosdefinimi i kompetencave të aksionarëve.

**Agim Salihu** i informoi të pranishmit lidhur me miratimin e Ligjit për ndërmarrjet publike dhe është paraparë të rregullohen edhe pagesat e aksionarëve të ndërmarrjeve publike. Ai gjithashtu informoi edhe lidhur me mos mundësinë e inkorporimit si pjesë përbërëse e kompleksit banesor “Dielli” në Ndërmarrjen Publike Banesore.

**U konstatua se u përkrahën raportet vjetore të komisioneve të aksionarëve të ndërmarrjeve publike: “Hortikultura”, “Termokos”, “Pastrimi”, “Trafiku Urban” dhe Ndërmarrja Publike Banesore dhe i dërgohen Kuvendit për shqyrtim.**

### **Pika e pestë Të ndryshme**

**Shefqet Sylejmani** shprehu shqetësimin lidhur me përfaqësimin në media si opozitë vetëm të PDK-së, duke shtuar se nuk është vetëm ajo opozitë, por jemi edhe të tjerët. Kjo shihet nga paraqitja e vërejtjeve dhe propozimeve tona në media. Kriticizmi nuk i bënë nder askujt. Mos deklarimi i medieve për opinionet tona paraqet shqetësim për ne, sepse nuk mund të shprehemi me gjuhën e tyre, por kemi opinionet tona të cilat shtrembërohen. Konkretisht, unë që jam pjesë e asamblesë komunale, subjektit politik të AAK-së dhe shef i Grupit parlamentar dhe nuk merret parasysh mendimi dhe prononcimi im, por merret i atij që nuk ka qenë fare, siç është rasti me Vetëvendosjen, që ka të bëjë me shkrimin ndaj prof. dr. Isa Mustafës. Shkrimet në gazetë nuk përkojnë me mendimin dhe prononcimin tim, gjë e cila na dëmton edhe neve.

Propozoi që Zyra për Informim të dalë me një komunikatë, e cila do t’i sqaronte gjërat. Përkritazi me pasimin e informatave nga ana e mediave, në veçanti nga gazeta ditore “Kosova sot”, Komiteti për Politikë dhe Financa, propozoi që Zyra për Informim të lëshojë një komunikatë, ku shkeljet e bëra nga kjo gazetë i ka vlerësuar si tendencioze, shantazhuese dhe keqpërdorim të fjalës së lirë.

Pason komunikata:

Pasqyrim i pasaktë i mendimit të asamblistëve opozitarë;

Tendencë për të pasqyruar vetëm PDK-në si opozitë në ansamble;

Mosdeklarim i mendimeve, i opinionëve tona, kur kërkohet nga ana e tyre;  
Anashkalim i përfaqësuesve të zgjedhur për efekt të shkrimit;  
Tërheqje e vëmendjes së opinionit nëpërmjet përfshirjes së pjesës të opozitës.  
Nga analiza e shkrimit të datës 13 mars 2012 në gazetën “Kosova sot”, po shihet çartë tendenca e gazetarit, apo e vet gazetës, për të realizuar qëllimin e tyre, duke folur për opozitën dhe në emër të saj. Në të vërtetë, i vetmi person kompetent si përfaqësues i opozitës në këtë shkrim është shefi i Grupit parlamentar të PDK-së, ndërsa të intervistuarit e tjerë nuk kanë të bëjnë fare me përfaqësimin opozitar në Komunën e Prishtinës. Sipas informacioneve tona, disa nga përfaqësuesit e grupeve parlamentare opozitare nuk janë pyetur fare, ndërsa edhe ata që janë intervistuar, nuk ia kanë marrë parasysh opinionet që t’i përfshijnë në shkrim.  
**Mustafë Krasniqi** shtoi se ky është shqetësim i madh për ne dhe përkrahu këtë komunikatë.

*Mbledhja mbaroi në orën 17:15.*

**Procesmbajtësja**  
**Alije Gusia**

**KRYESUESI I KOMITETIT**  
**Sami Hamiti, ecc. i dipl.**